



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primar / Dorezuar Prijemno / Protokolo Received / Delivered	16.06.2021	1	viti god year
Organ / Rjeshtja Organ / Jednoca Org / Rjesht	In Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPACK	3139/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.388/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.388/2021 të datës 06.05.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë rr. "Ismajl Dumoshi", nr.1, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.388/2021 e datës 06.05.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar sipas akt emërimit të datës 07.12.2011, në pozitën "Zyrtare ligjore", në Ministrinë e Financave. Me datën 21.04.2020, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.Prot.395, sipas të cilit ankuesja është caktuar si zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave dhe Transfereve. Këtë pozitë ankuesja e ka ushtruar deri me datën 01.04.2021, kur zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, ka shfuqizuar Vendimin me numër.Nr.23/2020, të datës 21.04.2020 dhe vendimin me numër Nr.53/2020 të datës, lidhur me emërimin e ankueses në këtë pozitë, ndërsa me datën 01.04.2021, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, ka nxjerrë vendimin me numër të protokollit Nr.Prot.440, sipas të cilit nëpunësin në pozitën "Zyrtar i lartë ligjor", e ka caktuar zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.



Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër të protokollit Nr.Prot.440, të datës 01.04.2021, brenda afatit ligjor, me datën 06.05.2021, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 388/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 17.05.2021 ,kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Me datën 24.05.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 388/2021 të datës 06.05.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 05.05.2021, i ankueses; Vendim me numër Nr.Prot.439 i datës 01.04.2021, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Vendim me numër Nr.Prot.440 i datës 01.04.2021, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Vendim me numër Nr.Prot.434 i datës 31.03.2021, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Vendim me numër Nr.Prot.435 i datës 31.03.2021, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Kërkesa për përgjigje ne ankesë e datës 17.05.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja ne ankesë e datës 24.05.2021, me shkresat e bashkangjitura nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Akt emërim i datës 01.04.2020 i nëpunësit E-maili zyrtar i datës 18.05.2021; Vendim me numër Nr.Prot.875 i datës 10.07.2020, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave; Vendim me numër Nr.Prot.395 i datës 21.04.2020, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Akt emërim i ankueses i datës 07.12.2011 se bashku me përshkrimin e detyrave të punës; E-maili zyrtar i datës 01.03.2021; E-maili zyrtar i datës 01.03.2021; E-maili zyrtar i datës 31.03.2021; E-maili zyrtar i datës 14.04.2020; E-maili i datës 31.03.2021; E-maili zyrtar i datës 14.04.2020; E-maili zyrtar i datës; E-maili zyrtar i datës 17.04.2020; E-maili zyrtar i datës 17.04.2020; E-maili zyrtar i datës 17.04.2020; E-maili zyrtar i datës 15.04.2020; E-maili zyrtar i datës 14.04.2020; E-maili zyrtar i datës 14.04.2020; E-maili zyrtar i datës 21.04.2020; E-maili zyrtar i datës 17.04.2020; E-maili zyrtar i datës 18.05.2021.

Vendim i datës 22.12.2020 me numër Nr.521/2020 i Komisionit disiplinor te Ministrisë se Punëve të Brendshme; Vendimi me numër A.nr.384/2019 i datës 07.12.2020 i Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës; Vendimi me numër Nr.3/2018 i datës 01.08.2019 i Komisionit disiplinor te Ministrisë se Administratës Publike; Shkresë zyrtare e datës 15.06.2016 nga ankuesi për Agjencinë e Shoqërisë se Informacionit; E-maili zyrtar i datës 18.08.2016; E-maili zyrtar i datës 16.07.2016; E-maili zyrtar i datës 15.07.2016; E-mailat zyrtar te datës 14.01.2021; E-maili zyrtar i datës 16.12.2020; E-maili zyrtar i datës 15.12.2020; Shkresë zyrtare nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti i financave për muajin tetor 2020; E-maili zyrtar i datës 03.04.2019; E-maili zyrtar i datës 05.04.2019; E-mailat zyrtar të datës 04.04.2019; E-mailat zyrtar të datës 22.03.2019; E-maili zyrtar i datës 13.03.2019; E-maili zyrtar i datës 26.02.2019; E-mailat zyrtar të datës 30.09.2014; E-maili zyrtar i datës 05.11.2019; E-maili zyrtar i datës 04.11.2019; Kërkesë e datës 05.11.2019; E-maili zyrtar i datës 04.11.2019; Kërkesë e datës 05.11.2019 dhe 12.11.2019; E-maili zyrtar i datës 06.11.2019; E-

maili zyrtar i datës 30.10.2019; E-maili zyrtar i datës 09.06.2020; E-maili zyrtar i datës 08.06.2020; Kërkesë e datës 08.06.2020, 10.06.2020; E-maili zyrtar i datës 12.08.2020; E-maili zyrtar i datës 10.08.2020; E-mailat zyrtar te datës 07.08.2020; E-mailat zyrtar të datës 19.01.2021; E-maili zyrtar i datës 14.07.2020; E-maili zyrtar i datës 10.07.2020; E-mailat zyrtar të datës 19.01.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës; Përgjigja në ankesë e datës 03.02.2021; Akt emërim i ankuesit i datës 03.10.2016 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Kërkesë për inicimin e procedurave për komision disiplinor e datës 25.11.2020; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 21.12.2020; Ftesë për seancë disiplinore e datës 25.11.2020; E-maili zyrtar i datës 26.11.2020; E-maili zyrtar i datës 25.11.2020; Vendim i datës 30.11.2020 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit disiplinor; E-maili zyrtar i datës 26.11.2020; E-maili zyrtar i datës 25.11.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve ne pune për vitin 2018 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e punës për vitin 2019 për ankuesin; Kërkesë për shërbim të vozitjes e datës; Vendimi me numër të protokollit Nr.01/2021 i datës 23.03.2021, i Komisionit Disiplinor te Ministrisë së Punëve të Brendshme; Ankesa e ankuesit me numër të protokollit 1898/2021, e datës 20.04.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër VK.nr.25/2021 i datës 02.06.2021 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A.nr.289/2021 të datës 20.04.2021, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në këto rrethana, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses është e pa bazuar, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të lëndës dhe provave të siguruara nga organi i punësimit dhe ankuesja, ka konstatuar se: Vendimi me numër Nr.Prot.436 i datës 01.04.2021, vendim ky i nxjerrë nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shfuqizimin e vendimeve me numër Nr.23/2020 të datës 21.04.2020 dhe Nr.53/2020 të datës 10.07.2020, për caktimin e ankueses si zëvendësuese të Drejtorit të Departamentit Ligjor, është vendim i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht me nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ku thuhet se: *"Që në rast mungese të drejtorit të Departamentit zëvendësohet nga Udhëheqësi i Divizionit i caktuar me shkrim nga vet drejtori, apo në rast pamundësie shëndetësore caktohet me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm"*, sepse në rastin konkret është në kompetencë të plotë të zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që në mungesë të pozitave për Drejtor të Departamentit dhe Udhëheqës të Divizionit në këtë ministri, të caktoj në hierarki zyrtarët nga nëpunësit civil të nivelit më të lartë të të njëjtit divizion. Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka analizuar lëndën dhe ka shqyrtuar provat dhe faktet e prezantuara si nga organi i punësimit ashtu edhe nga ankuesja, ka konstatuar se ankuesja deri me datën 01.04.2021 e ka ushtruar pozitën si zëvendësuese e Drejtorit të Departamentit Ligjor, nga pozita si *"Zyrtare ligjore"* në Departamentin Ligjor, e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, e që në rastin konkret pozita e ankueses në hierarki nuk është pozitë me e larte pas Udhëheqësit të Divizionit në këtë institucion.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se: Vendimi me numër Nr.Prot.440 i datës 01/04/2021, i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në lidhje me caktimin e nëpunësit si

zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor është vendim i drejtë edhe po ashtu i bazuar në dispozita ligjore, sepse nëpunësi është i punësuar sipas akt emërimit të datës 01.04.2020, në pozitën "Zyrtar i lartë për bashkëpunim ndërkombëtar financiar", që sipas vendimit me numër Nr.Prot.434 të datës 31.03.2021, i njëjti është transferuar për periudhën prej gjashtë (6) muajsh nga pozita Zyrtar i lartë për bashkëpunim ndërkombëtar financiar, në kuadër të Departamentit të politikave makroekonomike dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në pozitën Zyrtar i lartë ligjor në kuadër të Departamentit ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, pozitë kjo e cila në hierarki në mungesë të pozitës së Udhëheqësit të Divizionit në këtë institucion, është pozitë më e lartë se e ankueses, prandaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me rastin e caktimit të nëpunësit nga pozita si "Zyrtar i lartë ligjor" në Departamentin ligjor, si zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor, ka vepruar në pajtim me nenin 20 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ku thuhet se: "3. Udhëheqësi i divizionit, në rast të mungesës, zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë i të njëjtit divizion. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë, që ka përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil. Në rast pamundësie shëndetësore të udhëheqësit të divizionit, zëvendësimi caktohet nga drejtori i departamentit".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër Nr.34 të datës 31.03.2021 dhe vendimit me numër Nr.439 i datës 01.04.2021 mbi shfuqizimin e vendimeve me numër Nr.23/2020 të datës 21.04.2020 dhe Nr.53/2020, ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi konkretisht me Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.388/2021

Ardita PERÇUKU-SHYTI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

